REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"

Konsultim publik : Lagjia nr.5.

Data : *28.09.2026* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Salla e Këshillit Bashkiak.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesmarrësve 25, nga të cilat 2 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2027-2029 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Bekim Mema, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

I. Paraqitja e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit

Takimi u hap nga **Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Bekim Mema,** i cili ftoi banorët të paraqisnin problematikat dhe propozimet e tyre dhe të përcaktonin prioritetet që, sipas nevojave të komunitetit, duhet të merren në konsideratë gjatë planifikimit të buxhetit të vitit 2027 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029.

Pjesëmarrësit u ftuan të fokusoheshin në nevojat që lidhen me funksionet dhe shërbimet e Bashkisë Shkodër, përfshirë infrastrukturën rrugore, ujësjellës-kanalizimet, ndriçimin publik, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve, hapësirat publike, transportin, arsimin dhe nevoja të tjera të komunitetit.

II. Diskutimet, kërkesat dhe propozimet

Z. Sokol Zaimaj: Evidentoi një rrugicë rreth 70 m në zonën Dom Ndre Zadeja, ku ndriçimi është realizuar, por kërkohen ndërhyrje të tjera infrastrukturore. Kërkoi sistemimin e trotuareve të dëmtuara nga Ura e Thive deri te ish Dega e brendshme, përfshirë dëmtimet nga rrënjët e pemëve. Për shkollën shprehu vlerësim për riparimet e kryera, por kërkoi mirëmbajtje më të mirë të oborrit të madh, përmes operatorit të gjelbërimit ose punonjësve të dedikuar.

Znj. Valentine Goçaj, banore e rrugës Tepe 134: Ngriti gjendjen e rrugës pa trotuare dhe me pluhur pranë shkollës austriake dhe Dëshmorët e Prishtinës, duke e cilësuar ndërhyrjen urgjente. Kërkoi gjithashtu trajtimin e fasadës së një pallati me rreth 15 familje, të dëmtuar nga zjarri.

Z. Prel Gjoni, banor i lagjes 3 Heronjtë: Kërkoi ndërhyrje të plotë në rrugën Mark Ndou, rreth 200-300 m, ku sipas tij puna ishte nisur vite më parë por rruga vijon të ketë nevojë për rehabilitim urgjent.

Z. Dode Mehmetaj: Vlerësoi disa ndërhyrje të realizuara në Rajonin nr. 5, por ngriti problematika të pambaruara: mungesën e një këndi lojërash për fëmijët në zonën e pallateve të rrugës 7 Shaljanët; nevojën për më shumë masa sigurie rrugore; pastrimin jo të rregullt dhe menaxhimin e pikave të mbetjeve; si dhe problematikën e shtyllave prej druri të vendosura në trotuare.

Banor i zonës Dom Nikoll Mazreku: Kërkoi përfundimin e katër rrugicave që kanë mbetur të pashtruara, shtimin e një pike grumbullimi mbetjesh nga Floga drejt degëzimit për Qafëhardhi/Mar Lula dhe vendosjen e një ose dy bumeve pranë shkollës në zonë për rritjen e sigurisë rrugore.

Banorë të rrugicës Kapre: Kërkuan kanalizimin e ujërave të zeza dhe asfaltimin e rrugicës, ku jetojnë rreth 25 familje dhe përdoren ende gropa septike. Sipas diskutimit, ndriçimi është realizuar, ndërsa problem kryesor mbeten kanalizimet dhe asfaltimi.

Z. Gjek Sokoli: Mbështeti nevojën që Bashkia të bashkëfinancojë ose ndërhyjë në rrugët ku edhe komuniteti ka investuar. Kërkoi shqyrtimin e mundësisë për buxhetimin e rrugës "Qëndresa 1915" dhe përfundimin e bllokut Mar Lula.

Banorë të Rajonit nr. 5: Kërkuan trajtimin e rrugëve Mar Lula dhe Dom Nikoll Kaçorri, sistemimin e pusetave dhe asfaltit, si dhe verifikimin e punimeve nëntokësore pranë transformatorit. Një banor ngriti shqetësimin se kërkesat me firma të familjeve nuk kishin marrë përgjigje dhe kërkoi më shumë vëmendje për rrugicat e vogla që mbeten të pashtruara.

Znj. Kjeta Karafili, drejtoreshë e shkollës "Martin Camaj": Falënderoi për punën e kryer në shkollë, por kërkoi informacion më të plotë për projektin dhe përfshirjen e një terreni/hapësire sportive. Ngriti problematikën e përdorimit të oborrit si parkim dhe kërkoi masa për sigurinë e nxënësve, përfshirë vijëzimin përpara shkollës.

Z. Sokoli: Kërkoi që projektuesit e ndërhyrjeve në shkolla të bashkëpunojnë me drejtuesit e institucioneve arsimore dhe të konsultojnë nevojat reale të tyre përpara hartimit të projekteve.

Z. Gliton Dibra, përfaqësues i shkollës "Edith Durham": Kërkoi rikonstruksionin urgjent të tualeteve të katit të parë, mirëmbajtjen e kalçetos së jashtme, lyerjen e brendshme dhe trajtimin e lagështisë. Ngriti nevojën për përmirësimin e kushteve të edukimit fizik, pajisjen e disa klasave me kondicionerë dhe ndërhyrje në rrjetin elektrik për shkak të mbingarkesës.

Z. Gjon Baja: Ngriti problematikën e kolektorit pranë shkollës "Ndoc Mazi" dhe zonës së ish-Hardhive të Egra, ku ujërat e bardha dhe të zeza krijojnë erë dhe shqetësim. Kërkoi trajtimin e parkimit në aksin nga Katedralja drejt rrugës "Ndoc Mazi", ndërhyrje për kanalizimet dhe asfaltimin në Dom Ndre Zadeja dhe asfaltimin e tre shesheve të pushimit.

III. Evidentimi i prioriteteve dhe dokumentacioni

1. Sistemimi i trotuareve dhe rrugicave në zonën Dom Ndre Zadeja, Tepe, Mark Ndou dhe rrugët e tjera të evidentuara.
2. Krijimi dhe mirëmbajtja e këndeve të lojërave, oborreve dhe hapësirave të gjelbërta në zonat me densitet të lartë banimi.
3. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve dhe shtimi/ripozicionimi i pikave të grumbullimit.
4. Përfundimi i rrugicave të pashtruara në blloqet Mar Lula, Dom Nikoll Kaçorri dhe rrugica Kapre.
5. Shtimi i elementeve të sigurisë rrugore pranë shkollave dhe zonave me lëvizje të fëmijëve.
6. Përfshirja e drejtuesve të shkollave në hartimin e projekteve dhe realizimi i investimeve në "Martin Camaj", "Edith Durham" dhe "Ndoc Mazi".
7. Ndërhyrje në kanalizimet e ujërave të zeza dhe të bardha, kolektorë, rrjetin elektrik dhe asfaltimet e nevojshme.
8. Trajtimi i fasadës së dëmtuar nga zjarri dhe përmirësimi i kushteve të parkimit e aksesit në zonë.

Kërkesat, vërejtjet dhe propozimet e mësipërme administrohen si pjesë e dokumentacionit të këshillimit publik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe projektbuxhetin vjetor 2027. Ato pasqyrojnë ndërhyrjet dhe prioritetet e paraqitura gjatë takimit dhe nuk përbëjnë vendimmarrje të pjesëmarrësve.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

KONSULTIM PUBLIK: *" PËR DRAFT PROJEKT PLANIN BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"*

Lagjia nr.5 ***Datë: 28.09.2026***

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Valentin Gjeci	Tre Heronj Tepe	0692236788	vgeci@yahoo.co	
2.	Bep Capeli	Rrug: Tepe	0692274161	capeli.bep@gmail.com	
3.	Sabul Zaimaj	Bd. Mati	0674060150	zaimajsabul@gmail.com	
4.	Gerton Aliaj	Rajoni 5	0692732742	toni_aliaj@yahoo.it	
5.	Fatmir Kola	Mark Lula	0685163534	— —	
6.	Pal Pepaj	Rajoni 5	0682333464	palpepaj@yahoo.com	
7.	Klaudio Kuqi	Rajoni 5	0697075894	klaudiopepaj81@hotmail	
8.	Elvis Leka	Mark Lula	0689389487	leka-elvis@icloud.com	
9.	Ilian Leka	K. Mark Lula	0692219264	-	

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
10.	Ardenis Ibrahimaj	R. 5	0672000957		
11.	Albin Lolici	NSHPP	0682042990		
12.	Ilir Shk	DPMJR	0656211334		
13.	Edi Zajza	R. Nr.5	0682630040		
14.	Yesmina Jaçaj	R.5	0693652162		
15.	Angelina Marku	R 5			
16.	Ilion Bala	R-5	0692164728		
17.	Prelë Gjoni	R-5	0692074688		
18.	Ilion Spiteri	R.5	068 50 000 11		
19.	Lokal Kodra	L. Mark Deda	0692125236		
20.	Ergest Sekele	R. 5.	0682080875		
21.	Arno Foulu	Nr 5	0674384219		
22.	Alketa Hereftë	R5 Sh. M. Cami	0674068359		
23.	Ahlem Mustafa	R.5 Sh.M.Cami	0674060585		
24.	Zode Mehmeta	Lagja "Shtëpia"	0673232?7		
25.	Angjelin Voca	R. 5.	0695442805		
26.					
27.					
28.					
29.					